



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI PËR INFORMIMIN  
MBI DOKUMENTET E ISH  
SIGURIMIT TË SHTETIT**

**INSTITUTI I INTEGRIMIT  
TË ISH TË  
PËRNDJEKURVE POLITIKË**

Nr. 50/2 Prot. Datë 30/03/2020

Nr. 11 Prot. Datë 22/05/2020

**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI**

**Ndryshuar me Vendimin e Autoritetit**

**Nr. 202 datë 30/03/2020**

**Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit (më poshtë AIDSSH), përfaqësuar nga Kryetarja, Znj. Gentiana Sula;**

dhe

**Instituti i Integrimit të ish të Përndjekurit Politik (më poshtë IIPP), përfaqësuar nga Drejtori Z. Bilal Kola;**

Nisur prej interesit të përbashkët të dy Institucioneve palët bien dakord të lidhin këtë **Marrëveshje Bashkëpunimi** (më poshtë “**Marrëveshja**”).

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Kjo marrëveshje ka për qëllim rritjen e efektivitetit në fushën e:

- Plotësimin dhe përditësimin e arkivave të institucioneve respektive;
- Krijimin e një baze të dhënash të përbashkëta për të internuarit dhe dëbuarit, dhe vend-internimet e kampet e punës;

- Bashkëpunimin në projekte për kujtesën dhe teknikave më të reja për qasjen e saj drejt institucioneve arsimore;
- Bashkëpunimi për krijimin e databazit për të zhdukurit nga të dy institucionet.

**Neni 2**  
Objekti

Objekti i kësaj **Marrëveshje** është institucionalizimi i marrëdhënieve për aplikimin e procedurave që thjeshtojnë bashkëpunimin e ndërsjellë të palëve, në kuadër të identifikimit, grumbullimit, administrimin e dokumenteve e të materialeve arkivore të ish-sigurimit të shtetit dhe të organeve të diktaturës komuniste, si dhe bashkëpunimi në fushën e botimeve, kulturës dhe promovimit të saj, që dëshmojnë periudhën për krimet e komunizmit në Shqipëri dhe periudhën që ka funksionuar ish-sigurimi i shtetit.

**Neni 3**  
Baza ligjore

Baza ligjore e kësaj **Marrëveshje** është Ligji nr. 45/2015 “Për të drejtën e Informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, neni 17 i Rregullores “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit*”, miratuar me Vendimin nr.21, datë 09.05.2014 të Autoritetit dhe Ligji nr. 8246, datë 01.10.1997 “Për Institutin e Integrimit të të Përndjekurve”, pika 9 e VKM-së nr. 93, datë 27.02.2019, “*Për përcaktimin e tarifave dhe të pagesave për shërbimet ndaj institucioneve apo personave, që ofrohen nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit*”

**Neni 4**  
Sfera e bashkëpunimit

**AIDSSH** dhe **IIPP** angazhohen të bashkëpunojnë për përpunimin dhe trajtimin e çështjeve themelore që kanë të bëjnë me të përndjekurit politik, veçanërisht për vendet e kujtesës, ekzekutimit dhe vuajtjeve të dënimit, si dhe në aktivitetet e organizuara prej se cilës palë, sipas programeve të miratuara në bashkëpunim bilateral ndërmjet dy Institucioneve, që bëjnë pjesë në fushën e veprimtarisë së tyre.

Palët angazhohen të bashkëpunojnë për referimin e të zhdukurve, krijimin e bazës së të dhënave me akses nga të dy institucionet me emrat e personave të pagjetur.

**Neni 5**  
Të drejta dhe detyrimet e palëve

Në përbushje të kësaj **Marrëveshje, AIDSSH dhe IIPP** kanë këto të drejta dhe detyrime:

1. të bashkëpunojnë për identifikimin e secilit prej rasteve të gjetjes së të zhdukurve, nga ku AIDSSH, angazhohet të delegojë tek IIPP çdo individë për të dhënë informacion ose raport që i referohet këtyre rasteve me qëllim rritjen e eficencës së bashkëpunimit për realizimin me sukses të misionit të gjetjes së të zhdukurve;
2. të marrin pjesë në takime të organizuara nga secila palë, për çështje që janë objekt i kësaj Marrëveshje, sipas sferës së bashkëpunimit;
3. të bashkërendojnë punën për vendet e kujtesës të ekzekutimit dhe vuajtjes së dënimit politik me burgim dhe vuajtjes së dënimit në kampet e internimit;
4. AIDSSH angazhohet të bashkëpunojë për referimin e rasteve për dëmshpërblimin dhe rehabilitimin pranë IIPP-së;
5. të organizojnë, hapin ose shkëmbejnë ekspozita që kanë si bazë pasurinë dokumentare apo kulturore në fushat respektive që dy Institucionet mbulojnë sipas ligjit;
6. të organizojnë konferanca, takime, workshop-e për të nxitur ndërgjegjësimin e të gjithë atyre që u janë përpunuar/ruajtur të dhënat nga ish-sigurimi i shtetit, gjatë periudhës së diktaturës komuniste, me qëllimin krijimin e një kulturë gjithëpërfshirëse për njojjen e dokumentacionit arkivor të kësaj periudhe.

**Neni 6**  
Koordinimi ndërmjet palëve

1. Në zbatim të kësaj **Marrëveshje, AIDSSH dhe IIPP** do të caktojnë nga një person kontakti.
2. Personat e kontaktit do të mbajnë takime ndërmjet tyre në varësi të nevojës për shkëmbim informacioni dhe do të informojnë titullarin e institucionit në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshje.
3. Komunikimi mes palëve do të jetë në formë zyrtare shkresore, duke mos përjashtuar format me të shpejta të komunikimit elektronik.
4. Palët do të njoftojnë reciprokisht në rast se ndryshohet personi i kontaktit.

**Neni 7**  
Përmirësimet, Ndryshimet, Shtesat

1. Palët mund të bëjnë përmirësimë, ndryshime dhe/apo shtesa në këtë **Marrëveshje**, bazuar në pëlqimin e ndërsjellë të tyre.

3

- Çdo përmirësim, ndryshim dhe/apo shtesë do të bëhet vetëm me shkrim nga titullarët e AIDSSH dhe IIPP, apo nga persona të autorizuar prej tyre dhe do të hyjnë në fuqi pas nënshkrimit të tyre.

### **Neni 8 Pronësia intelektuale**

Të gjitha pronat intelektuale (intervista, dëshmi, filma, etj.) të zotëruara nga secila Palë para nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje do të mbeten pronë e vetme e Palës e cila i ka në pronësi. Pronësia intelektuale e krijuar si rezultat i bashkëpunimit sipas kësaj Marrëveshjeje do të jetë në pronësi të përbashkët e të dyja palëve.

Palët i jepin leje jo-ekskluzive, të revokueshme, pa pagesë, njëri-tjetrit, për të përdorur materialet (në çfarëdo lloj forme qofshin) në pronësi të secilit, në mbështetje të këtij bashkëpunimi.

Në raste të tjera të kërkesave individuale dhe studimore të të përndjekurve, të identifikuar nga Instituti i Integrimit të ish-të Përndjekurit Politik, në mënyrë për ti ardhur në ndihmë qytetarit për t'u njojur dhe për të patur pa shpërblim dokumentacionin që dëshmon vuajtjet e tij, apo të të afërmve të tij, aplikohet tarifë e reduktuar deri në masën 100%.

Për aplikimin e kësaj pike ish-i përndjekuri kërkues pranë AIDSSH-së duhet të jetë i pajisur me statusin e ish-të përndjekurit, apo në mungesë të tij me një dokument që vërteton përndjekjen nga IIPP-ja.

### **Neni 9 Mirëbesimi**

- AIDSSH** dhe **IIPP** do të respektojnë parimin e mirëbesimit të ndërsjellë.
- Palët duhet të mbajnë në mirëbesim të gjitha dokumentet, të dhënat dhe informacionet e tjera të shkëmbbyera prej tyre në lidhje me këtë Marrëveshje.

### **Neni 10 Afati i marrëveshjes**


- Kjo **Marrëveshje** do të lidhet për një kohëzgjatje të pacaktuar.
- Marrëveshja mund të përfundojë nga secila **Palë** nëpërmjet dërgimit të një njoftimi me shkrim **Palës** tjetër, (të paktën një muaj përpara).
- Në rast të përfundimit të kësaj Marrëveshje, palët do t'u përbahen detyrimeve që rrjedhin nga kjo Marrëveshje, përsa i përket informacionit të shkëmbyer përpëra datës së përfundimit të saj.

**Neni 11**  
Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

1. Kjo **Marrëveshje** hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj.
2. Marrëveshja është hartuar në Tiranë, në katër kopje origjinale, dy prej të cilave depozitohen në **Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit** dhe dy të tjera në **Institutin e Integrimit të Ish të Përndjekurve**.

**PËR**

**Autoritetin për Informimin mbi**



**PËR**

**Institutin e Integrimit të Ish**

**të Përndjekurve**

**Bilal KOLA**

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI PËR INFORMIMIN  
MBI DOKUMENTET E ISH  
SIGURIMIT TË SHTETIT**

**INSTITUTI I INTEGRIMIT  
TË ISH TË  
PËRNDJEKURIT POLITIK**

Nr. 50/1 Prot. Datë 15/01/2020

Nr. 12 Prot. Datë 15/01/2020

**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI**

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit (më poshtë AIDSSH), përfaqësuar nga Kryetarja, Znj. Gentiana Sula;  
dhe

Instituti i Integrimit të ish të Përndjekurit Politik (më poshtë IPP), përfaqësuar nga Drejtori Z. Bilal Kola;

Nisur prej interesit të përbashkët të dy Institucioneve palët bien dakord të lidhin këtë Marrëveshje Bashkëpunimi (më poshtë “Marrëveshja”).

**Neni 1**  
Qëllimi

Kjo marrëveshje ka për qëllim rritjen e efektivitetit në fushën e:

- Plotësimin dhe përditësimin e arkivave të institucioneve respektive;
- Krijimin e një baze të dhënash të përbashkëta për të internuarit dhe dëbuarit, dhe vend-internimet e kampet e punës;

- Bashkëpunimin në projekte për kujtesën dhe teknikave më të reja për qasjen e saj drejt institucioneve arsimore;
- Bashkëpunimi për krijimin e databazit për të zhdukurit nga të dy institucionet.

## Neni 2 Objekti

Objekti i kësaj **Marrëveshje** është institucionalizimi i marrëdhënieve për aplikimin e procedurave që thjeshtojnë bashkëpunimin e ndërsjellë të palëve, në kuadër të identifikimit, grumbullimit, administrimin e dokumenteve e të materialevë arkivore të ish-sigurimit të shtetit dhe të organeve të diktaturës komuniste, si dhe bashkëpunimi në fushën e botimeve, kulturës dhe promovimit të saj, që dëshmojnë periudhën për krimet e komunizmit në Shqipëri dhe periudhën që ka funksionuar ish-sigurimi i shtetit.

## Neni 3 Baza ligjore

Baza ligjore e kësaj **Marrëveshje** është Ligji nr. 45/2015 “Për të drejtën e Informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, neni 17 i Rregullores “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit*”, miratuar me Vendimin nr.21, datë 09.05.2014 të Autoritetit dhe Ligji nr. 8246, datë 01.10.1997 “Për Institutin e Integrimit të të Përndjekurve”, pika 9 e VKM-së nr. 93, datë 27.02.2019, “*Për përcaktimin e tarifave dhe të pagesave për shërbimet ndaj institucioneve apo personave, që ofrohen nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit*”

## Neni 4 Sfera e bashkëpunimit

**AIDSSH** dhe **IIPP** angazhohen të bashkëpunojnë për përpunimin dhe trajtimin e çështjeve themelore që kanë të bëjnë me të përndjekurit politik, veçanërisht për vendet e kujtesës, ekzekutimit dhe vuajtjeve të dënimit, si dhe në aktivitetet e organizuara prej secilës palë, sipas programeve të miratuara në bashkëpunim bilateral ndërmjet dy Institucioneve, që bëjnë pjesë në fushën e veprimtarisë së tyre.

Palët angazhohen të bashkëpunojnë për referimin e të zhdukurve, krijimin e bazës së të dhënave me akses nga të dy institucionet me emrat e personave të pagjetur.

**Neni 5**  
Të drejta dhe detyrimet e palëve

Në përbushje të kësaj **Marrëveshje, AIDSSH** dhe **IIPP** kanë këto të drejta dhe detyrime:

1. të bashkëpunojnë për identifikimin e secilit prej rasteve të gjetjes së të zhdukurve, nga ku AIDSSH, angazhohet të delegojë tek IIPP çdo individë për të dhënë informacion ose raport që i referohet këtyre rasteve me qëllim rritjen e eficencës së bashkëpunimit për realizimin me sukses të misionit të gjetjes së të zhdukurve;
2. të marrin pjesë në takime të organizuara nga secila palë, për çështje që janë objekt i kësaj Marrëveshje, sipas sferës së bashkëpunimit;
3. të bashkërendojnë punën për vendet e kujtesës të ekzekutimit dhe vuajtjes së dënimit politik me burgim dhe vuajtjes së dënimit në kampet e internimit;
4. AIDSSH angazhohet të bashkëpunojë për referimin e rasteve për dëmshpërblimin dhe rehabilitimin pranë IIPP-së;
5. të organizojnë, hapin ose shkëmbejnë ekspozita që kanë si bazë pasurinë dokumentare apo kulturore në fushat respektive që dy Institucionet mbulojnë sipas ligjit;
6. të organizojnë konferenca, takime, workshop-e për të nxitur ndërgjegjësimin e të gjithë atyre që u janë përpunuar/ruajtur të dhënat nga ish-sigurimi i shtetit, gjatë periudhës së diktaturës komuniste, me qëllimin krijimin e një kulturë gjithëpërfshirëse për njojjen e dokumentacionit arkivor të kësaj periudhe.

**Neni 6**  
Koordinimi ndërmjet palëve

1. Në zbatim të kësaj **Marrëveshje, AIDSSH** dhe **IIPP** do të caktojnë nga një person kontakti.
2. Personat e kontaktit do të mbajnë takime ndërmjet tyre në varësi të nevojës për shkëmbim informacioni dhe do të informojnë titullarin e institucionit në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshje.
3. Komunikimi mes palëve do të jetë në formë zyrtare shkresore, duke mos përjashtuar format me të shpejta të komunikimit elektronik.
4. Palët do të njoftojnë reciprokisht në rast se ndryshohet personi i kontaktit.

**Neni 7**  
Përmirësimet, Ndryshimet, Shtesat

1. Palët mund të bëjnë përmirësimet, ndryshime dhe/apo shtesa në këtë **Marrëveshje**, bazuar në pëlqimin e ndërsjellë të tyre.

- Çdo përmirësim, ndryshim dhe/apo shtesë do të bëhet vetëm me shkrim nga titullarët e **AIDSSH** dhe **IIPP**, apo nga persona të autorizuar prej tyre dhe do të hyjnë në fuqi pas nënshkrimit të tyre.

## Neni 8 Pronësia intelektuale

Të gjitha pronat intelektuale (intervista, dëshmi, filma, etj.) të zotëruara nga secila Palë para nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje do të mbeten pronë e vetme e Palës e cila i ka në pronësi. Pronësia intelektuale e krijuar si rezultat i bashkëpunimit sipas kësaj Marrëveshjeje do të jetë në pronësi të përbashkët e të dyja palëve.

Palët i japid leje jo-ekskluzive, të revokueshme, pa pagesë, njëri-tjetrit, për të përdorur materialet (në çfarëdo lloj forme qofshin) në pronësi të secilit, në mbështetje të këtij bashkëpunimi.

Në raste të tjera të kërkesave individuale dhe studimore të të përndjekurve, të identifikuar nga Instituti i Integrimit të ish-të Përndjekurit Politik, në mënyrë për ti ardhur në ndihmë qytetarit për t'u njohur dhe për të patur pa shpërbirim dokumentacionin që dëshmon vuajtjet e tij, apo të të afërmve të tij, aplikohet tarifë e reduktuar deri në masën 100%.

Për aplikimin e kësaj pike ish-i përndjekuri kërkues pranë AIDSSH-së duhet të jetë i pajisur me statusin e ish-të përndjekurit, apo në mungesë të tij me një dokument që vërteton përndjekjen nga IIPP-ja dhe/ose AIDSSH.

## Neni 9 Mirëbesimi

- AIDSSH** dhe **IIPP** do të respektojnë parimin e mirëbesimit të ndërsjellë.
- Palët duhet të mbajnë në mirëbesim të gjitha dokumentet, të dhënat dhe informacionet e tjera të shkëmbbyera prej tyre në lidhje me këtë Marrëveshje.

## Neni 10 Afati i marrëveshjes

- Kjo **Marrëveshje** do të lidhet për një kohëzgjatje të pacaktuar.
- Marrëveshja mund të përfundojë nga secila **Palë** nëpërmjet dërgimit të një njoftimi me shkrim **Palës** tjetër, (të paktën një muaj përpara).
- Në rast të përfundimit të kësaj Marrëveshje, palët do t'u përbahen detyrimeve që rrjedhin nga kjo Marrëveshje, përsa i përket informacionit të shkëmbbyer përpala datës së përfundimit të saj.


**Neni 11**  
Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj.
2. Marrëveshja është hartuar në Tiranë, në katër kopje origjinale, dy prej të cilave depozitohen në **Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit** dhe dy të tjera në **Institutin e Integrimit të Ish të Përndjekurve**.

**PËR**

**Autoritetin për Informimin mbi**

**Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit**



**PËR**

**Institutin e Integrimit të Ish**

**të Përndjekurve**

**Bilal KOLA**

**DREJTORI I PËRCJITHSHËM**

